



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 410 Prot.

Tiranë, më datë 06 .08 .2018

VENDIM

Nr. 364, datë 27.07.2018

PËR

VAZHDIMIN E PROCEDURAVE TË LEGALIZIMIT

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27/2018, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, i ndryshuar me V.K.M. Nr. 756, datë 26.10.2016, si dhe Kodit të Procedurave Administrative, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 27.07.2018, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë edhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e vazhdimin të procedurave të legalizimeve për objektin: “Godinë e kombinuar 2 kate + podrum”, Lagjja Nr. 2, rruga “Pandeli Cale” Nr. 14, brenda kufirit të Zonës së mbrojtur të qytetit Korçë, kërkesë e Z. Gavrill Kristo Cerava;
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR I KKR

Daniel Pirushi

KRYETAR

Mirela KUMBARO FURXHI

